

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

6 Janar, 2022

Të Nderuar Nxënës dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,


Një stuhi dimërore pritet të sjellë borë, reshje të akullta dhe temperatura të ftohta në zonën tonë duke filluar nga sonte vonë, duke krijuar kushte të rrezikshme udhëtimi për ditën e Premte. Duke pasur parasysh sigurinë e nxënësve dhe të personelit tonë, të **gjitha shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias do të kalojnë në mësimin virtual të Premten, më 7 Janar 2022.** Mësimet virtuale do të bëhen dhe mësuesi i fëmijës suaj do t'ju njoftojë për orarin.

Të gjitha ndërtesat dhe zyrat e Drejtorisë Arsimore do të mbyllen, duke përfshirë: Qendrat e Mbështetjes së Teknologjisë Familjare, Qendrat Rajonale të Shërbimeve të Specializuara, zyrat në 440 North Broad Street, vendet e shkollës për ushqim dhe të gjitha ndërtesat shkollë. Kjo do të mundësojë pastrimin e sigurtë të borës nga të gjitha rrugët, vendkalimet dhe shkallët në pronat e Drejtorisë.

Gjithashtu, si drejtoritë arsimore dhe kompanitë në të gjithë vendin, ne vazhdojmë të përjetojmë vështirësi të personelit të lidhura me COVID. Ne e dimë se studentët, personeli dhe familjet tona dëshirojnë të dinë rreth funksionimit të shkollës për javën e ardhshme. Siç e kemi ndarë më parë, ne jemi të përkushtuar të marrim vendime shkollë për shkollë bazuar në të dhënat më aktuale të personelit, të cilat mund të ndryshojnë shpejt. Drejtuesit e drejtorisë do të vazhdojnë të monitorojnë të dhënat e personelit për të gjitha shkollat tona çdo ditë gjatë gjithë kësaj jave dhe gjatë fundjavës. Vendimet fillestare të nivelit të shkollës për javën e ardhshme **bazuar në të dhënat e së Premtes** do të ndahen të Premten deri në orën 16.00 pm.

Kujdesuni dhe jini të sigurtë gjatë stuhisë së dimrit. Unë vazhdoj të jem jashtëzakonisht mirënjohës për durimin dhe partneritetin tuaj ndërsa punojmë së bashku në interesin më të mirë të të rinjve tanë.

Me vlerësim,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias